**Përfaqësuar nga**
**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**Enkelejdi JOTI**

**Date: ____/____.2021**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**
**QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" TIRANË**
**DREJTORIA JURIDIKE**

Nr. 471/11 Prot. Tiranë, më 18.02.2021

**KONTRATË FURNIZIMI NR. 1**

E lidhur sot me datë 18/02/2021 pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë midis palëve:

- **Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë**, me **NIPT J61911026A**, me adresë: Rruga e Dibrës, Nr. 372 - Tirane, përfaqësuar ligjërisht nga Drejtori i Përgjithshëm, Z. Enkelejdi JOTI, këtu e në vijim referuar si "**Autoriteti Kontraktor (AK)**",

Dhe,

- Operatorit Ekonomik të Suksesshëm, Shoqëria "**GTS - Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k." Shpk.**, me **NIPT J61905015B**, me adresë: Tirane, Vaqarr, me Administrator Z. Matteo Fumagalli Romario, përfaqësuar në këtë Marrëveshje Kuadër nga Z. Besnik HALILI, me Prokurën me nr. Rep. 16, Kol 9, datë 10.01.2019, Noter Dhurata M. Verdha, Dhoma e Noterisë Tiranë, që këtu e në vijim do të quhet "**Kontraktuesi**".

**Neni 1**
**Objekti i kontratës**

Objekt i kësaj kontrate është "**Furnizim me oksigjen te lëngshëm mjekësor për nevojat e QSUNT**", me **REF-80448-11-27-2020**.

**Neni 2**
**Baza Ligjore**

Kjo kontratë lidhet mbështetur në Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, Marrëveshjes Kuadër nr. 471/7 Prot., datë 18.02.2021, Dokumentet Standarde të Tenderit si dhe Ligjit nr. 7850 datë 29.07.1994 "Kodin Civil i Republikës së Shqipërisë".

**Neni 3**
**Vlera e kontratën**

| Nr | Emërtimi | Njësia | Sasia e O2 për Kontratën e I në liter | Çmim për Njësi për Liter | Vlerë Total | Përbërësit në përqindje |
|---|---|---|---|---|---|---|



1029

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Furnizimin me Oksigjen të Lëngshëm Mjeksor | Litër | 2 239 104 | 135,21 | 302'749'251,84 | Oksigjen | $O_2$ | 99,70% | |
| | | | | | | Monoksid karboni | CO | 0,13 | vmp (volum për milion) |
| | | | | | | Bioksid karboni | $CO_2$ | 0,11 | vpm |
| | | | | | | Ujë | $H_2O$ | 0,06 | vpm |
| | | | | | | Të tjera | | | mungojnë |

**Vlera totale e kësaj kontratë për sasinë e sipërcituar është 302'749'251,84 (treqind e dy milion e shtatëqind e dyzet e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë e një presje tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.**
**Shënim: Oksigjen të Lëngshëm Mjeksor është bar për përdorim spitalor dhe nuk aplikohet TVSH;**
Çmimi total i kontratës përfshin kostot dhe tarifat, duke përfshirë taksat dhe tarifat doganore të lidhura me dorëzimin e mallrave, pagesa për transportin, testimet, ngarkimet, shkarkime, udhëzimet, manualet dhe dokumentet në gjuhën e specifikuar dhe të nevojave për përdorim të rregullt të mallrave si dhe të gjitha detyrimet e tjera të parashikuara në legjislacionin shqiptar.
Çmimet mbeten të pandryshuara gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

**Neni 4**
**Testimet dhe inspektimet**

Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës.
Kosto e këtyre testimeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktuesi brenda kushteve të çmimit të kontratës. Me shpenzimet e tij, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë Kontraktuesit të bëjë testime ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Mallrat janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testimeve. Më tej, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së Kontraktuesit, Autoriteti Kontraktor do të bie dakort të ndryshojë grafikun e levrimit. Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Mall që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës. As ekzekutimi i testeve as inspektimi i Mallrave nuk do ta çlirojë Kontraktuesin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.
**Ne rast mospërdorimi për arsye objektive të medikamenteve, duke sjellë si pasojë afrimin e skadencës, shoqëria furnitore duhet të marrë masa për tërheqjen e medikamenteve dhe zëvendësimin e tyre me të njëjtin artikull por me afat më të gjatë skadence.**

**Neni 5**
**Specifikimet teknike**

Mallrat, të cilat do të furnizohen nga kontraktuesi, do të kenë specifikimet teknike sipas dokumenteve te tenderit, Formularit te deklaratës mbi origjinën e mallit dhe deklaratës mbi përmbushjen e specifikimeve teknike.

| Emërtimi | Njësia | Përbërësit në përqindje | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Furnizimin me Oksigjen të Lëngshëm Mjeksor | Litër | Oksigjen | $O_2$ | 99,70% | |
| | | Monoksid karboni | CO | 0,13 | vmp (volum për milion) |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Bioksid karboni | $CO_2$ | 0,11 | vpm |
| | | Ujë | $H_2O$ | 0,06 | vpm |
| | | Të tjera | | | mungojnë |

**Afati i skadencës do të jetë:** Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

**Neni 6**
**Afati i Lëvrimit dhe Marrja në dorëzim**

E gjithë sasia e mallit duhet të lëvrohet, në Tiranë, në depot ku do të kryhet shërbimi i magazinimit, kolaudimit dhe shpërndarjes së medikamenteve në QSUT "Nënë Tereza". Malli do të shoqërohet me faturë ku do nënshkruhet dhe procesverbali i kolaudimit në lidhje me sasinë dhe specifikimet teknike. Dorëzimi i mallit do të kryhet nga administratori i shoqërisë ose nga një person i autorizuar prej tij. Në çdo kohë por para afatit të mbarimit të kontratës do të bëhet rakordimi dhe nënshkrimi i aktit të marrjes në dorëzim për gjithë sasinë e mallit objekt i kësaj kontrate. **Lëvrimi i mallit do të bëhet sipas kërkesave të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse;**

**Neni 7**
**Mënyra dhe afatet e pagesës**

Pagesa për lëvrimin e mallrave do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e dorëzimit të proçes – verbaleve dhe dokumentacionit tjetër nga ana e Kontraktuesit.
Pagesa do të bëhet në lekë shqiptarë dhe urdhër xhirimi në llogarinë e Kontraktuesit në: Bankën ______________, me Nr. llogarie __________________.
Autoritetit Kontraktor është i detyruar të likuidojë pagesën, për furnizimin e kryer sipas faturave tatimore të depozituara, miratuar nga QSU "Nënë Tereza". Data e pagesës do të jetë dita që fondet debitohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

**Neni 8**
**Vonesa ne Zbatim dhe Zgjatja e Afatit**

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të likujdojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në dorëzimin e mallrave brenda periudhës së zbatimit të specifikuar në kontratë.
Autoriteti Kontraktor mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontratktor duhet t'i japë Kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.
Autoriteti Kontraktor do të jetë dakord për një zgjatje të afatit në rastin e forcës madhore.
Autoriteti Kontraktor mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, ai duhet të njoftojë me përpikmëri dhe menjëherë Autoritetin Kontraktor, sipas formës së përcaktuar me shkrim për vonesën, shkakun, dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse ky i fundit është dakord me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës së nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

## Neni 9
## Forca Madhore

Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likujduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.
Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.
Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktor. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

## Neni 10
## Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar

Kontraktuesi, kur nuk realizon këtë kontratë brenda afatit te përcaktuar në të për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore për dorëzimin e vonuar do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

## Neni 11
## Negociatat dhe Amendamentet

Palët nuk do negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshojë mjaftueshëm kushtet që përbejnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.
Asnjë amendament tjetër i kontratës nuk do të jete i vlefshëm pa qene me shkrim, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga përfaqësuesit e autorizuar të të dy palëve.
Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhen me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

## Neni 12
## Ndërprerja për Mosplotësim

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

a) Kontraktuesi dështon në dorëzimin e Mallrave brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

## Neni 13

- Njoftimin e Fituesit nga Autoriteti Kontraktor
- Formularin e Sigurimit te Kontratës
- Lista e Informacionit Konfidencial

Te gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga aplikimi i kësaj Kontrate dhe që nuk mund te zgjidhen me mirëkuptim, në baze të ligjit palët mund ti drejtohen Gjykatës kompetente për zgjidhjen e tyre.

**Neni 18**
**Ndjekja e Kontratës**

Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, si person përgjegjës për ndjekjen e kësaj kontrate dhe raporton tek Titullari i Autoritetit Kontraktor/Sektori i Prokurimeve për realizimin e kontratës deri në përfundimin e saj.

**Neni 19**
**Hyrja në fuqi e Kontratës**

Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët.
Palët pasi e lexuan dhe e gjetën atë konform ligjit dhe interesave të tyre e nënshkruajnë atë me vullnetin e tyre të plote.
Kjo kontratë hartohet në 5 (pesë) ekzemplarë, nga të cilat një ekzemplarë i jepet Kontraktuesit.

| | |
|---|---|
| **KONTRAKTUESI:** | **AUTORITETI KONTRAKTOR:** |
| **GTS – Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k.,** | **QSU "Nënë Tereza"** |
| | **Përfaqësuar nga** |
| **ADMINISTRATORI** | **DREJTORI I PËRGJITHSHËM** |
| **Matteo Fumagalli ROMARIO** | **Enkeleid JOTI** |
| **Përfaq.Ligjor Z. Besnik HALILI** | |
| **Prokurë nr. Rep. 16, Kol 9, datë 10.01.2019** | |
| **Noter Dhurata M. Vetdha, Dhoma e Noterisë Tiranë** | |



10

**Ndërprerja për Shkak të Falimentimit**

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë. Autoriteti Kontraktor duhet t'i japë Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

**Neni 14**
**Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik. Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen. Autoriteti kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Mallrat e pranuara dhe Shërbimet në Lidhje me to, të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Mallrave dhe Shërbimeve në Lidhje me to. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesit do t'i kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

**Neni 15**
**Kohëzgjatja e kontratës**

Kohëzgjatja e kësaj kontrate është: **nga momenti i nënshkrimit të kontratës me afat 4 (kater) muaj, ose deri në ezaurimin e plotë të sasisë.**

**Neni 16**
**Sigurimi i kontratës**

Kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktor garancinë e sigurimit të kontratës, 10% të vlerës së kontratës në shumën prej **30'274'925,18 (tridhjetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e njëzet e pesë presje tetëmbëdhjetë) Lek.**
Kontrata të sigurohet deri në përfundim të kontratës. Shuma e sigurimit të kontratës duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktori në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës. Garancia e sigurimit të kontratës do t'i kthehet Kontraktuesit pas përfundimit të kohëzgjatjes së kontratës.

**Neni 17**
**Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve.**

Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshje me negociata direkte. Pjesë integrale e kësaj kontrate është dhe dokumentacioni i mëposhtëm i prokurimit të kësaj procedure:

- Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik
- Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/ pjesëmarrjes
- Specifikimet Teknike
- Formulari i çmimit të ofertës
- Marrëveshja Kuadër me nr. 471/6 date 18.02.2021
- Kushtet e Përgjithshme se Kontratës
- Kushtet e Veçanta se Kontratës

## ANEKS KONTRATE

Sasia dhe çmimi për njësinë e mallit që do të lëvrohet si më poshtë :

| Nr. | Emërtimi | Njësia | Sasia e pritshme e O2 | Çmimi për njësi (1 litr O2 / Lekë pa tvsh) | Vlera | Përbërësit e O2 në përqindje: | | | | OE i Suksesshëm | Prodhuesi | Origjina |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Furnizimin me Oksigjen të Lëngshëm Mjeksor | Litër | 2'239'104 | 135,21 | 302'749'251,84 | Oksigjen | O2 | 99,70% | | GTS-Gazra Teknik e Shqiptare sh.p.k., | GTS – Gazra Tekniko Shqiptare sh.p.k., | Shqipëri |
| | | | | | | Monoksid karboni | CO | 0,13 | vmp (volum për milion) | | | |
| | | | | | | Bioksid karboni | CO2 | 0,11 | vpm | | | |
| | | | | | | Ujë | H2O | 0,06 | vpm | | | |
| | | | | | | Të tjera | | | mungojnë | | | |

**Shënim: Për barin oksigjen të lëngshëm mjekësor nuk aplikohet TVSH;**

Specifikimet e Barit O2 i lëngshëm:

| Emërtimi | Njësia | Përbërësit në përqindje | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Furnizimin me Oksigjen të Lëngshëm Mjeksor | Litër | Oksigjen | O2 | 99,70% | |
| | | Monoksid karboni | CO | 0,13 | vmp (volum për milion) |
| | | Bioksid karboni | CO2 | 0,11 | vpm |
| | | Ujë | H2O | 0,06 | vpm |
| | | Të tjera | | | mungojnë |

**Afati i skadencës do të jetë:** Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

**KONTRAKTUESI:**
**GTS – Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k.,**

**ADMINISTRATORI**

**Matteo Fumagalli ROMARIO**
**Përfaq.Ligjor Z. Besnik HALILI**
**Prokurë nr. Rep. 16, Kol 9, datë 10.01.2019**
**Noter Dhurata M. Verdha, Dhoma e Noterisë Tiranë**

**AUTORITETI KONTRAKTOR:**
**QSU "Nënë Tereza"**
**Përfaqësuar nga**
**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**Enkelejd JOTI**

Xerox® VersaLink® B7030 Multifunction Printer

# Startup Page

| | |
|---|---|
| Device Name | "VersaLink B7030" |
| Total Impressions | 133442 |
| Serial Number | 3942879449 |
| Activation Date | 29.02.2020 |
| PCL 6 5e® | Version 100 1 |
| Software Version | |
| System | Version 58 50 61 |
| Controller ROM | Version 1 57.3 |
| IOT ROM | Version 54.24.0 |
| ADF ROM | Version 31.17.0 |
| Panel ROM | Version 154.116.11 |
| Boot ROM | Version 11.1.216 |
| SJFI | Version 4.7.0 |
| SSMI | Version 2.5.1 |
| Contents | Version 5.0.0 |
| RSEP | Version 1.8.25 |
| Software Updated | 17/12/2019 10 00 AM |
| Installed RAM | 2.00 GB |
| ROM Fonts Available | 83 PCL® |
| Hard Disk Solid State Disk | 320072 MB |
| Duplex Module | Installed |
| Finisher | Not Installed |
| Supplies Plan | Not Activated |
| USB 3 0 | Enabled |
| USB 3 0 Printing | Enabled |
| USB 3.0 Scanning | Enabled |
| Ethernet | Auto , "9C 93.4E:B8:23 E7" |
| 802.1X | Disabled |
| TCP IP IPv4 | "192.168.10.98" |
| TCP IP IPv6 | "fe80::9e93:4eff:feb8:23e7" |
| DNS Name | |
| Web Page | http://192.168.10.98 80 |
| Connectivity Mobile Workflows | AirPrint |
| | Mopria |
| | Google Cloud Print |

Printed On : 05 [illegible] 2021 11 [illegible] AM

Copyright © 2017-2019 Xerox Corporation. All rights reserved. Xerox® and XEROX and Design® and VersaLink® are trademarks of Xerox Corporation in the United States and/or other countries

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Reanimac Neurologji | | 16 | |
| | Salla operatore | | 6 | |
| | Dhoma e zgjimit | | 4 | |
| | Rezonanca | | 1 | |
| | Skaneri | | 1 | |
| SHUMA DALJE TANKERI RI | | | 98 | |
| Qendra Konsultave | | | 1 | 4/1 |

## SPECIFIKIME TEKNIKE PËR OKSIGJENIN MJEKËSOR TË LËNGSHËM (BAR)

**Përbërësit në përqindje**

| | | |
|---|---|---|
| Oksigjen | $O_2$ | 99,70 % |
| Monoksid karboni | CO | 0,13 vmp (volum për milion) |
| Bioksid karboni | $CO_2$ | 0,11 vpm |
| Ujë | $H_2O$ | 0,06 vpm |
| Të tjera | | mungojnë |

Afati i skadencës do të jetë: ***Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.***

**Kushtet e furnizimit me oksigjen shëndetësor të lëngshëm (bar)**

Furnizimi bëhet me autobotet e furnizuesit të pajisur me leje për:

1. Transport gazra mjekësore nën presion nga MNZSH. (**Leje nga MNZSH – Kur është e aplikueshme**)

2. Çertifikatë miratimi ADR të lëshuar nga **DPSHTRR. (https://www.dpshtrr.al/)**.

Tankerat e Oksigjenit të QSUT-së janë si më poshtë :

1. Tanker 10.000 litërsh prapa Spitalit Nr.1 (6 katësh)
2. Tanker 10.000 litërsh pranë Spitalit Onkologjik
3. Tanker 3.000 litërsh pranë Spitalit Pediatri
4. Tanker 13.000 litërsh pranë Spitalit Neurokirurgji
5. Tanker 10.000 litërsh prapa Qëndrës Teknike të Spitalit të Ri
6. Tanker 10 000 litersh prane Spitalit Infektiv
7. Tanker 10 000 litersh prane Spitalit Infektiv

Xerox® VersaLink® B7030 Multifunction Printer

# Startup Page

| | |
|---|---|
| Device Name | "VersaLink B7030" |
| Total Impressions | 133446 |
| Serial Number | 3942879449 |
| Activation Date | 29-02-2020 |
| PCL6 5e® | Version 100.1 |
| Software Version | |
| System | Version 58.50.61 |
| Controller ROM | Version 1.57.3 |
| IOT ROM | Version 54.24.0 |
| ADF ROM | Version 31.17.0 |
| Panel ROM | Version 154.116.11 |
| Base ROM | Version 11.1.216 |
| SJFI | Version 4.7.0 |
| SSMI | Version 2.5.1 |
| Contents | Version 5.0.0 |
| RSEP | Version 1.8.25 |
| Software Updated | 17-12-2019 10:00 AM |
| Installed RAM | 2.00 GB |
| ROM Fonts Available | 83 PCL® |
| Hard Disk Solid State Disk | 320072 MB |
| Duplex Module | Installed |
| Finisher | Not Installed |
| Supplies Plan | Not Activated |
| USB 3.0 | Enabled |
| USB 3.0 Printing | Enabled |
| USB 3.0 Scanning | Enabled |
| Ethernet | Auto , "9C:93:4E:B8:23:E7" |
| 802.1X | Disabled |
| TCP-IP IPv4 | "192.168.10.98" |
| TCP-IP IPv6 | "fe80::9e93:4eff:feb8:23e7" |
| DNS Name | |
| Web Page | http://192.168.10.98:80 |
| Connectivity Mobile Workflows | AirPrint |
| | Mopria |
| | Google Cloud Print |

Printed On : 05-03-2021 11:20 AM

Copyright © 2017-2019 Xerox Corporation. All rights reserved. Xerox® and XEROX and Design® and VersaLink® are trademarks of Xerox Corporation in the United States and / or other countries

Shënim: *Numri i tankerave mund të jetë objekt ndryshimi sipas nevojave të AK.*

J. **Kushte të veçanta;**

A. Tankerat Nr. rendor 2, 3, 4 , 5, 6, 7 nuk janë pronë e QSUT-së dhe **Operatori Ekonomik fitues duhet të marrë parasysh zëvendësimin e tyre brenda 5 ditëve**, **duke furnizuar më parë rampat e oksigjenit të gaztë me një sasi konsumi ditor si më poshtë :**

1. Rampa e oksigjenit pranë Spitalit Onkologjik 100 (njëqind) bomola 40 litërshe me presion 125 bar
2. Rampa e oksigjenit pranë Spitalit Pediatri 40 (dyzet) bombola 40 litërshe me presion 125 bar.
3. Rampa e oksigjenit pranë Spitalit Neurokirurgji 40 (dyzet) bombola 40 litërshe me presion 125 bar.
4. Rampa e oksigjenit e Spitalit të Ri me 60 (gjashtëdhjetë) bombola 40 litërshe me presion 125 bar.

B. Operatori Ekonomik **duhet të pajisë me nga 6 (gjashtë) bombola oksigjeni gaz rampat e mësipërme dhe rampat e Kardiokirurgjisë dhe Spitalit të Specialiteteve (Francez) për siguruar gatishmerinë e furnizimit me oksigjen të shërbimeve spitalore.** Sasia e oksigjenit të gaztë të konsumuar gjatë ditëve të instalimit të tankerave do të konvertohet në oksigjen të lëngët.

**SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT**

**Sasia e mallit që kërkohet:**

| Nr | Emërtimi | Njësia | Sasia e pritshme e O2 |
|---|---|---|---|
| 1 | **Furnizimi me Oksigjen të Lëngshëm Mjeksor** | **Litër** | **2 239 104** |

**Nga të dhënat që Sektori Teknik pranë Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse ka, si dhe verfifikimit të kryer nga teknikët e specialiteteve pranë çdo pavioni, më poshtë do të gjeni të gjitha daljet e oksigjenit që janë në funksion.**

**Tankerat e Oksigjenit të QSUT-së janë si më poshtë :**

1. Tanker 10.000 litërsh prapa Spitalit Nr.1 (6 katësh)
2. Tanker 10.000 litërsh pranë Spitalit Onkologjik
3. Tanker 3.000 litërsh pranë Spitalit Pediatri
4. Tanker 13.000 litërsh pranë Spitalit Neurokirurgji
5. Tanker 10.000 litërsh prapa Qëndrës Teknike të Spitalit të Ri
6. Tanker 10 000 litersh prane Spitalit Infektiv
7. Tanker 10 000 litersh prane Spitalit Infektiv

Shënim: *Numri i tankerave mund të jetë objekt ndryshimi sipas nevojave të AK.*



641

II. **Kushte të veçanta;**

C. Tankerat Nr. rendor 2, 3, 4 , 5, 6, 7 nuk janë pronë e QSUT-së dhe Operatori Ekonomik fitues duhet të marrë parasysh zëvendësimin e tyre brenda 5 ditëve, duke furnizuar më parë rampat e oksigjenit të gaztë me një sasi konsumi ditor si më poshtë :

1. Rampa e oksigjenit pranë Spitalit Onkologjik 100 (njëqind) bomola 40 litërshe me presion 125 bar.
2. Rampa e oksigjenit pranë Spitalit Pediatri 40 (dyzet) bombola 40 litërshe me presion 125 bar.
3. Rampa e oksigjenit pranë Spitalit Neurokirurgji 40 (dyzet) bombola 40 litërshe me presion 125 bar.
4. Rampa e oksigjenit e Spitalit të Ri me 60 (gjashtëdhjetë) bombola 40 litërshe me presion 125 bar.

D. Operatori Ekonomik duhet të pajisë me nga 6 (gjashtë) bombola oksigjeni gaz rampat e mësipërme dhe rampat e Kardiokirurgjisë dhe Spitalit të Specialiteteve (Francez) për siguruar gatishmerinë e furnizimit me oksigjen të shërbimeve spitalore. Sasia e oksigjenit të gaztë të konsumuar gjatë ditëve të instalimit të tankerave do të konvertohet në oksigjen të lëngët.

**Tabela e daljes së oksigjenit nëpër pavionet dhe godinat e QSUT**

| SHËRBIMI SPITALOR | KLINIKA | DALJE $O_2$ | NR. I DALJEVE | TANKERI FURNIZUES |
|---|---|---|---|---|
| SËMUNDJET E BRENDSHME | Toksilogjia | kati 0 | 4 | Nr.1 |
| | Kardiologjia | Kati I (Çdo dhomë nga 2 dalje dhe 2 dhoma nga 3 dalje) | 44 | |
| | | Kati II (Çdo dhomë nga 2 dalje dhe 2 dhoma nga 3 dalje) | 44 | |
| | | Reanimacioni | 14 | |
| | | Salla Koronare | 5 | |
| | Hematologjia | Njeri krah komplet dhomat, krahu tjetër reanimacioni 3 dalje) | 21 | |
| | Gastroenterelogjia | | 15 | |
| | Endokrinologjia | | 16 | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nefrologjia | | 23 | |
| | Reparti i Dializës | Dy dalje dhe zgjatim me tubo fleksibël | 10 | |
| | Shuma | | 196 | |
| KARDIO- KIRURGJIA | Salla operatore | | 5 | Nr.1 |
| | Reanimacioni | | 15 | |
| | Vazalet | Salla | 1 | |
| | | Reanimacion | 2 | |
| | Kati II | | 30 | |
| | Shuma | | 53 | |
| FRANCEZ | Blloku Operator | | 10 | Nr.1 |
| | O.R.L.(pavion) | | 10 | |
| | Reanimacion | | 12 | |
| | Shuma | | 32 | |
| SHUMA DALJE TANKERI 1 | | | 281 | |
| KIRURGJI E PËRGJITHSHME | Klinka Parë 39 | Pavion | 25 | Nr.2 |
| | | Reanimacion | 6 | |
| | | Salla | 8 | |
| | Klinka Dytë 48 | Pavion | 39 | |
| | | Reanimacion | 8 | |
| | | Salla | 8 | |
| | Klinika Tretë 37 | Pavion | 25 | |
| | | Reanimacion | 6 | |
| | | Salla | 6 | |
| | Shuma | | 131 | |
| DJEGJE-PLASTIKA | Pavioni i 2 | | 7 | Nr.2 |
| | Pavioni i 3 | | 2 | |



1061

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Pavioni i 4 | | 2 | |
| | Reanimacioni | | 15 | |
| | Salla operatore | | 8 | |
| | **Shuma** | | **34** | |
| INFEKTIV<br><br>COVID 1 | Reamotologji | | 31 | Nr.4<br>+<br>Nr.4/1 |
| | Urgjenca re | | 13 | |
| | Reanimacioni | | 8 | |
| | Kati I | | 26 | |
| | Kati II | | 25 | |
| | Kati III komplt | | 25 | |
| | Alergologji | | 25 | |
| | **Shuma** | | **153** | |
| ONKOLOGJIK | Salla operatore | | 4 | Nr.2 |
| | Radioterapia | | 3 | |
| | Reanimacioni | | 6 | |
| | Kati II | | 4 | |
| | Kati III | | 2 | |
| | Kati IV | | 2 | |
| | **Shuma** | | **19** | |
| **SHUMA DALJE TANKERI 2** | | | **184** | |
| PEDIATRI E VJETER | Pavioni V | | 2 | Nr.3 |
| | Urgjenca re | | 3 | |
| | Pavioni VII | | 1 | |
| | Pavioni VIII | | 1 | |
| | Pavioni X | | 1 | |
| | Pavioni XI | | 2 | |
| | Ambulanca | | 2 | |
| | **Shuma** | | **12** | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| PEDIATRI E RE | Dializa | | 2 | |
| | Kirurgjisë | | 12 | |
| | Salla operatore | | | |
| | Reanimacioni | | 36 | |
| | Pavioni III | | 35 | |
| | Pavioni IV | | 15 | |
| | Pavioni I | | 21 | |
| | Pavioni II | | 3 | |
| | **Shuma** | | **124** | |
| **SHUMA DALJE TANKERI 3** | | | **136** | |
| NEURO-KIRURGJIA | Salla operatore | | 8 | Nr.5 |
| | Rezonanca magnetike | | 2 | |
| | Reanimacioni | | 14 | |
| | Kati III | | 12 | |
| | Kati IV | | 12 | |
| | **Shuma** | | **48** | |
| NEUROLOGJIA | Reanimacioni | | 24 | |
| | Kati II | | 4 | |
| | Kati III | | 4 | |
| | Kati IV | | 4 | |
| | **Shuma** | | **36** | |
| **SHUMA DALJE TANKERI 5** | | | **84** | |
| SPITALI I RI I URGJENCË PRANIMIT + COVID 3 | Urgjenca Nr.1 | | 27 | Tankeri Ri |
| | Urgjenca Nr.2 | | 17 | |
| | Reanimac. Qendror | | 14 | |
| | Ditori | | 12 | |
| | Reanimac Neurologji | | 16 | |
| | Salla operatore | | 6 | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Dhoma e zgjimit | | | 4 | |
| | Rezonanca | | | 1 | |
| | Skaneri | | | 1 | |
| SHUMA DALJE TANKERI RI | | | | 98 | |
| Qendra Konsultave | | | | 1 | 4/1 |

**Kontratat do te jepen brenda periudhës:** Nga momenti i lidhjes se Marrëveshjes Kuader me OE të shpallur fitues, me afat perfundimtar 12 muaj nga data e nënshkrimit të MK.

**Afatet e lëvrimit:** QSU 'Nënë Tereza' do të lidhë kontratë në bazë të nevojave të saj në çdo 4 mujor. Perjashtimisht ketij percaktimi, autoriteti kontraktor mund të lidhin kontratë për çdo nevojë për oksigjen që del e paparashikuar dhe është e domosdoshme në cdo kohë.

Numri unik: {6AA35B92-1BE8-44AB-8458-234B6C318C40}

**Numri serie & fature: 89173025**

K42108801C

0000891730253

# FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS

Datë: 18.02.2021

Për: (emri,adresa e autoritetit kontraktor) QSUT "Nene Tereza"

Në emër të: GTS-GAZRA TEKNIKE SHQIPTARE SH.P.K. J61905015B,
(Kontraktori)

Procedura e prokurimit (lloji i procedurës) E hapur mbi kufirin e lartë monetar

Përshkrim i shkurtër i kontratës (objekti)

"Furnizim me oksigjen te lëngshëm mjekësor për nevojat e QSUNT"

Publikimi (nëse zbatohet) : Buletini i Njoftimeve Publike (Numri, Data) :

Njoftim ne rruge elektronike ne adresen zyrtare te APP-se,www.app.gov.al ;

Duke iu referuar procedurës së lartëpërmendur, dhe me kusht që (emri i ofertuesit të përcaktuar fitues) t'i jetë akorduar kontrata.

GTS-GAZRA TEKNIKE SHQIPTARE SH.P.K, J61905015B,

Ne vërtetojmë se GTS-GAZRA TEKNIKE SHQIPTARE SH.P.K. J61905015B,

ka derdhur një depozitë pranë ALBSIG SHA në një shumë prej (monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifre):

Lekë 30.274.925,18 TridhJetë e Milion e DyQindë e ShtatëdhJetë e KatërMijë e NëntëQindë e NJëzetë e Pesë , Tetëmbëdhjetë

si kusht për sigurimin e egzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me (emri i autoritetit kontraktor)

QSUT "Nene Tereza"

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e (emri i autoritetit kontraktor)

QSUT "Nene Tereza"

vlerën e siguruar, brenda 15(pesëmbedhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos përmbushjen e kushteve të kontratës.

Ky sigurim është i vlefshëm deri në zbatim të plotë të kontratës, por jo më vonë se afati i përfundimit të kryerjes së punimeve, shërbimeve, etj., si përcaktuar në dokumentet e prokurimit.

ALBSIG SHA

Drejtori

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
QËNDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" TIRANË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 471/28 Prot.

Tiranë, më 05.04.2021

**AMENDIM NR. 1**
**I KONTRATËS SË FURNIZIMIT ME NR. 471/11 PROT. DATË 18.02.2021**

E lidhur sot me datë 05.04.2021 pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë midis palëve:

- **Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", me NIPT: J61911026A**, me adresë: Rruga e Dibrës, Nr. 372, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Z. Enkelejdi JOTI, që këtu e në vijim do të quhet **"Autoriteti Kontraktor"**,

Dhe

- **Operatorit Ekonomik të Suksesshëm, Shoqëria "GTS - Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k." Shpk., me NIPT J61905015B**, me adresë: Tirane, Vaqarr, me Administrator Z. Matteo Fumagalli Romario, përfaqësuar në Marrëveshjen Kuadër nga Z. Besnik HALILI, me Prokurën me nr. Rep. 16, Kol 9, datë 10.01.2019, Noter Dhurata M. Verdha, Dhoma e Noterisë Tiranë, dhe përfaqësuar në këtë Amendim Kontrate nga Z. Ergys Halili me Autorizim, mbajtës i letërnjoftimit elektronik me nr. H21129097C, që këtu e në vijim do të quhet **"Kontraktuesi"**.

**MEQENËSE**

- Ndërmjet palëve si më sipër, në përfundim të procedurës së prokurimit, me objekt: **"Furnizim me oksigjen te lëngshëm mjekësor për nevojat e QSUNT"**, me **REF-80448-11-27-2020, është lidhur Marrëveshja Kuadër me nr. 471/7 prot., datë 18.02.2021**, me kohëzgjatje 12 muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër, me FL 908'315'199 (nëntëqind e tetë milion e treqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH;
- Bazuar në Marrëveshjen Kuadër, sipas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, është **lidhur Kontrata e Furnizimit me nr. 471/11 Prot., Datë 18.02.2021**, me objekt: "Furnizim me oksigjen te lëngshëm mjekësor për nevojat e QSUNT", me REF-80448-11-27-2020, me kohëzgjatje: nga momenti i nënshkrimit të kontratës me afat 4 (katër) muaj, ose deri në ezaurimin e plotë të sasisë, për sasinë e O2 prej 2'239'104 (dy milion e dyqind e tridhjetë e nëntë mijë e njëqind e katër) Litër oksigjen i lëngshëm, me vlerë 302'749'251,84 (treqind e dy milion e shtatëqind e dyzet e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë e një presje tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.
- Në Nenin 11 të Kontratës, 'Negociatat dhe Amendamentet', citohet se: Palët nuk do negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshojë mjaftueshëm kushtet që përbejnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.

ofertuesi atehere, APP vlerëson se, per shtimin e vendit te origjines se mallit pra pervec Shqiperise te jene edhe vende te tjera, autoriteti juaj kontraktor duhet te sigurohet qe malli i cili do te vije nga shtetet e propozuara te jete me specifikime të njejta me ato të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe për të cilat është nënshkruar kontrata në fjalë, sipas parashikimeve te nenit 60/1 i LPP.

- Duke qenë se Kontraktuesi "GTS - Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k." Shpk., është pjesë e SOL Group, me seli qendrore në Itali, lider në tregun botëror dhe evropian për prodhimin e gazrave teknik dhe oksigjenit mjekësor, nga i cili në komunikimet e cituara më sipër, Kontraktuesi parashtron shtimin e mundësinë së furnizimit (oksigjen i lëngshën/lëndë e parë për prodhim oksigjeni) nga Maqedonia (SOL SEE) por edhe nga Italia (SOL Itali), të cilat janë pjesë e të njëjtit grup (SOL Group - http://www.solgroup.com/en/where-we-are).
- Duke qenë se, sipas rekomandimeve të APP, si dhe sipas parashikimeve të Nenit 60 të LPP (Rregullat që zbatohen për kontratën), pika 1, ku citohet se: *Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese*, kushtet e kontratës bazë nuk ndryshojnë, qoftë për nga specifikimet teknike, qoftë për nga çmimi i ofertuar për litër oksigjen,
- Duke qenë se i vetmi ndryshim/amendim që Kontraktuesi kërkon është shtimi i mundësisë së prodhuesit/vendit të origjines, duke ruajtur të gjitha parashikimet e tjera kontraktore,
- Si dhe duke qenë se Kontraktuesi merr përsipër të zbatojë të gjitha detyrimet dhe të përmbushë të gjitha parashikimet ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë, të cilat rregullojnë objektin e kontratës dhe objektin e këtij amendimi kontrate,
- Duke qenë se ekzistojnë konditat e nevojshme për lidhjen dhe vlefshmërinë e amendimit të kontratës.

**Palët, me vullnet të plotë e të pavesuar, bien dakord, të bëjnë këtë Amendim Kontratë, me kushtet dhe termat në vijim:**

**Neni 1**
**Baza Ligjore**

1.1 Ky amendim kontrate lidhet në mbështetje të Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodin Civil i Republikës së Shqipërisë, VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", te ndryshuar, Kërkesën e administruar në nr. 471/25 prot., datë 02.04.2021, komunikimet elektronike të administruar në nr. 471/26 prot., dhe 471/27 prot., datë 08.04.2021, si dhe në nenin 11 të Kontratës nr. 471/11 prot., datë 18.02.2021,

**Neni 2**
**Objekti i amendimit të kontratës**

2.1 Objekt i këtij amendimi kontrate është: **Kontrata me nr. 471/11 prot., datë 18.02.2021, me objekt: "Furnizim me oksigjen te lëngshëm mjekësor për nevojat e QSUNT", me REF-80448-11-27-2020.**

**Neni 3**
**Negociatat**

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | min me Oksigjen të Lëngshëm Mjeksor | | | 135,21 | 302'749'251;84 | Monoksid karboni | CO | 0,13 | vmp (volum për milion) | GTS-Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k., | GTS – Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k., / SOL Group / SOL SEE d.o.o. | Shqipëri / Itali / Maqedoni |
| | | | | | | Dioksid karboni | $CO_2$ | 0,11 | vpm | | | |
| | | | | | | Ujë | $H_2O$ | 0,06 | vpm | | | |
| | | | | | | Të tjera | | | mungojnë | | | |

4.2. Dispozitat e tjera të kontratës mbeten të pandryshuara.

**Neni 5**
**Hyrja në fuqi e amendimit të kontratës**

5.1 Ky amendim kontrate hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.
5.2 Ky amendim kontrate hartohet në 5 (pesë) ekzemplare nga të cilat 1 (një) ekzemplar i jepet Kontraktuesit.

**KONTRAKTUESI:**
**GTS – Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k.,**

**ADMINISTRATORI**

**Matteo Fumagalli ROMARIO**
**Përfaq.Ligjor Z. Besnik HALILI**
**Prokurë nr. Rep. 16, K019, datë 10.01.2019**
**Përfaqësues me Autorizim Z. Ergys HALILI**

**AUTORITETI KONTRAKTOR:**
**QSU "Nënë Tereza"**
**Përfaqësuar nga**
**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**Enkelejdi JOTI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Nr. 457 Prot. Tiranë, më 27.01.2020

URDHËR PROKURIMI

Nr. 41, Datë 27.01.2020

Mbështetur në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, në nenin 60 Kreu VII të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, në Vendimin Nr. 135, datë 20.02.2013, të Këshillit të Ministrave "Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë për disa mallra dhe shërbime", të ndryshuar, në Udhëzimin e APP-së Nr. 6, datë 16.01.2018 "Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, Rekomandimet Nr. 13566 Prot., datë 06.11.2017 dhe Nr. 10419 Prot., datë 26.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik si dhe në Urdhrin Nr. 368, datë 02.05.2019 "Për delegim kompetence",

URDHËROJ:

Të kryhet prokurimi i fondit limit/vlera e pritshme e kontratave në total prej **6,191,395,386 (gjashtë miliard e njëqind e nëntëdhjetë e një milion e treqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë) Lekë pa TVSH**, financuar nga buxheti i shtetit, për **"B1-Blerje barna Anti-infektive të përgjithshëm, Anestezi Reanimacion, Antituberkulare, Antineoplastike dhe Immunomodulatore, antiparazitare, dermatologjike, hormonale sistemike, hormonet seksuale, Gjaku dhe organet formuese të gjakut dhe Sistemi Respirator", ndarë në 121 lote** - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj".

Shumatorja e çmimeve për njësi për 121 lote: 880,854.4 lekë pa TVSH

Lloji i procedurës së prokurimit është: e hapur mbi kufirin e lartë monetar- prokurim me mjete elektronike - mallra.

Kjo lloj marrëveshje kuadër aplikohet për arsyet e mëposhtme:

1. Lidhur me prokurimin e këtij objekti, janë të përcaktuara të gjitha kushtet kryesore të marrëveshjes kuadër të tilla si artikujt pra barnat, specifikimet e sakta teknike, kushtet e rëndësishme lëvrimit si dhe sasitë e pritshme të kërkuara.
2. Nga përvoja e prokurimit të barnave në vite nga MSHMS si organ Qëndror Blerës çmimet e tregut kanë rezultuar të jenë të qëndrueshëm dhe nuk ndryshojnë në funksion të momentit apo vendit të lëvrimit. (bëhet fjalë për çmime të miratuara zyrtarisht)

3. Duke qenë se në këtë marrëveshje kuadër përfshihen shumë autoritete kontraktore, për arsye teknike dhe organizative, lëvrimi nga operatorë të ndryshem ekonomikë për sejcilin lot, nuk do të ishte i favorshem, pasi do të shoqërohej me kosto shtesë dhe vonesa të furnizimit, për shkak të kryerjes së procedurave të minikonkurimit nga AK, palë e kësaj MK.
4. Ndryshimi i OE në rast se kjo marrëveshje do të lidhej me disa OE për sejcilin lot (pra rrjedhimisht ku jo të gjitha kushtet do të ishin të përcaktuara) do të shkaktonte kosto shtesë, pasiguri dhe konfuzion për OE të suksseshëm, gjë që do te shoqërohej me rritjen e afateve të lëvrimit duke patur parasysh që barnat kanë afat skandence dhe kryesisht importohen nga jashtë. Lidhja e MK me një OE të vetëm për lot, shoqërohet me mirëorganizimin e këtij të fundit për sigurimin e mallrave në kohë, sigurimin e një rezerve dhe furnizimin në kohën e kerkuar nga AK. Gjithashtu siguria për kontratat që parashikohet të lidhen i jep mundësi OE të ulë kostot e ofertës.
5. Marreveshja kuadër me disa OE ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara nuk konsiderohet kontratë. Kjo do të thotë që AK nuk kanë mekanizma detyruese për OE të shpallur të suksesshem për pjesëmarjen e tyre në minikonkurse dhe rrjedhimisht në lidhjen e kontratave pas zhvillimit te tyre. Pasiguria dhe vonesat mund të sjellin dështime në furnizmin me këto materiale për spitalet ne kohën e duhur, duke patur impakt direkt tek pacienti.
6. Organi Qendror Blerës është në gjendje të krijojë një ide të plotë dhe të saktë mbi të gjitha transaksionet që kryhen në bazë të kesaj MK-së të përzgjedhur, si dhe të minimizojë vështirësinë për të komunikuar dhe për të monitoruar autoritetet kontraktore të përfshira që do të bënin thirrjet potenciale për kontratat individuale.
7. Lidhur me MK ku kushtet nuk janë të përcaktuara, ekziston gjithashtu risku sa i takon organizimit kompleks të tyre dhe fakti se njohuria mbi mënyrën se si funksionon sistemi i MK dhe procedurat e thirrjeve për kontrata individuale do të mbeteshin të paqarta për shumë autoritete kontraktore periferike.
8. Në rastin e një marrëveshje kuadër, ku janë përcaktuar të gjitha kushtet, autoriteti kontraktor jep lote, bazuar në një furnizues. Në rastin e marrëveshjes kuadër konkrete ku janë përcaktuar të gjitha kushtet, autoriteti kontraktor lidh marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, për çdo lot.
9. Nga eksperiencat e mëparshme të prokurimit të këtij objekti nga kjo Ministri, ka rezultuar se numri i OE lokal pjesëmarrës ka qenë i kufizuar për lot. Marrëveshja me kushte jo të përcaktuara do të kërkonte kualifikimin e tre OE për lot (minimumi dy) gjë e cila rrezikon realizimin e një pjese të madhe të loteve.
10. Me qëllim garantimin e furnizimeve në afatet kohore të përcaktuara për sejcilin AK përfitues si dhe duke marrë në konsideratë numrin e madh të këtyre të fundit, MK me një OE të vetëm fitues për sejcilin lot do të garantonte sigurinë e furnizimeve sipas kushteve të përcaktuara dhe brenda afateve të kërkuara duke sjellë stabilitet në menaxhimin e kontratave dhe të nevojave të AK.

Lloji i procedurës është përzgjedhur në zbatim të nenit 30, 35/1, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, nenit 33 të Kreut IV dhe Kreut V të VKM-

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Nr. 4571/145 Prot. Tiranë, më 27.09.2020

# FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

Për:

**1. Bashkimi I Operatoreve ekonomik : GTS-Gazra Teknike Shqiptare shpk me NIPT J61905015 B Adresa : Tirane, Vaqarr & Messer Albagaz shpk me NIPT K78317002 F Adresa: Tirane, Vore Autostrada Tirane-Durres, km-4.5 me perfaqesues GTS-Gazra Teknike Shqiptare shpk**

* * *

Procedura e prokurimit: **e hapur mbi kufirin e lartë monetar- prokurim me mjete elektronike - mallra, REF-49328-02-05-2020**

| | |
|---|---|
| Lot41 Oxygen | REF-49423-02-05-2020 |
| Lot42 Oxygen | REF-49425-02-05-2020 |

Përshkrim i shkurtër i kontratës: ***"B1-Blerje barna Anti-infektive të përgjithshëm, Anestezi Reanimacion, Antituberkulare, Antineoplastike dhe immunomodulatore, antiparazitare, dermatologjike, hormonale sistemike, hormonet seksuale, Gjaku dhe organet formuese të gjakut dhe Sistemi Respirator", ndarë në 121 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj""*.**

**Fondi limit/vlera e pritshme e kontratave në total për të gjitha lotet për 24 muaj - 6,191,395,386 (gjashtë miliard e njëqind e nëntëdhjetë e një milion e treqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë) Lekë pa TVSH.**

**Shumatorja e cmimeve për njësi për 121 lote: 880,854.4 lekë pa TVSH**

Data e zhvillimit të tenderit:**03.04.2020**

Kohëzgjatja e kontratës: **24 muaj nga nënshkrimi I Marrëveshjes Kuadër**

Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X, oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**Per Lotin 41 Oxygen Gaz per perdorim mjeksor, i kompresuar x 100%**

- Eshte paraqitur BOE GTS-Gazra Teknike Shqiptare shpk & Messer Albagaz shpk me cmim total për njësi të ofertës prej 34.56 (tridhjetë e katër pikë pesëdhjet e gjashtë) leke pa tvsh.

**Për Lotin 42 Oxygen Gaz per perdorim mjeksor, i lengshem x 100%**

- Eshte paraqitur BOE GTS-Gazra Teknike Shqiptare shpk & Messer Albagaz shpk me cmim total për njësi të ofertës prej 135.4 (njëqindë e tridhjet e pesë pikë katër) leke pa tvsh.

Nuk ka pasur ofertues te s'kualifikuar

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur njoftojme:

1. **BOE GTS-Gazra Teknike Shqiptare shpk & Messer Albagaz shpk,me perfaqesues GTS-Gazra Teknike Shqiptare shpk, për oferten e paraqitur për Lotin 41 Oxygen Gaz per perdorim mjeksor, i kompresuar x 100% , me vlere 34.56 (tridhjetë e katër pikë pesëdhjet e gjashtë) leke pa tvsh:**

2. **BOE GTS-Gazra Teknike Shqiptare shpk & Messer Albagaz shpk,me perfaqesues GTS-Gazra Teknike Shqiptare shpk, për oferten e paraqitur Lotin 42 Oxygen Gaz per perdorim mjeksor, i lengshem x 100%, me vlerë prej 135.4 (njëqindë e tridhjet e pesë pikë katër) leke pa tvsh**

jane identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë *[Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale]*,

brenda ____5 (pesë)________ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 14.04.2020

Ankesa: Jo

* * *

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Gelardina Prodani**